




UDHËZIM PËR MËNYRËN E PARAQITJES SË ANKESAVE

Solar4Kosovo II/ Sistemi Ngrohtorja Solare e Qytetit në Kosovë është një projekt i kompanisë Termokos (kompania e ngrohjes së qytetit të Komunës së Prishtinës), i cili realizohet në Prishtinë. Projekti parashikon zgjerimin e kapaciteteve për prodhimin e energjisë termike për rrjetin e ngrohjes së qytetit në Prishtinë, duke përdorur energjinë diellore.

Projekti ka për qëllim të furnizojë me ngrohje shtesë amvisëritë, institucionet dhe bizneset, duke i lidhur ato me rrjetin e ngrohjes qendrore TERMOKOS, si dhe të kontribuojë në qëllimin e përgjithshëm për të krijuar një furnizim më ekonomik dhe të qëndrueshëm me ngrohje në Prishtinë.

Projekti do të financohet përmes huave dhe granteve të siguruara nga Qeveria Gjermane, përmes Bankës Gjermane për Zhvillim (*Kreditanstalt für Wiederaufbau (KfW)*), me bashkëfinancim nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe një kontributit të vetë Agjencisë Zbatuese të Projektit.

Nëse keni ndonjë koment, pyetje ose ankesë lidhur me zbatimin e projektit, ju lutemi që t'i paraqisni ato përmes njërës prej këtyre kanaleve.

	<p>Përmes email-it</p> <p>Ankesat mund të dorëzohen duke dërguar një email në adresën: solar4kosova@termokos.org (në vëmendje: Njësia për Zbatimin e Projektit, TERMOKOS Sh.A. Rr. 28 Nëntori nr. 181, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës) ose duke plotësuar formularin për ankesat që është i disponueshëm në faqen zyrtare të internetit të Termokos: https://termokos.org/v2/</p>
	<p>Personalisht</p> <p>Ankesat mund të dorëzohen në kantierin e ndërtimit ose përmes kutive të ankesave të vendosura në zyrat e Termokos gjatë orarit të punës nga 08:00 deri në 16:00. Adresa për dorëzimin e ankesës është:</p> <p>TERMOKOS Sh.A. Rr. 28 Nëntori nr. 181, Solar4Kosovo Njësia për Zbatimin e Projektit 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës Telefon: +383 44 966 150 apo +383 45 966 150 apo +383 44 555 680</p>
	<p>Me postë</p> <p>Ankesat mund të dorëzohen përmes postës në adresën vijuese: TERMOKOS Sh.A. Rr. 28 Nëntori nr. 181, Solar4Kosovo Njësia për Zbatimin e Projektit 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës</p>

Formulari i ankesës në format të shtypur do të jetë i qasshëm në të gjitha kantieret e ndërtimit si dhe në zyrat e Termokosit, ndërkohë që forma elektronike për ankesa mund të shkarkohet nga faja e internetit: <https://termokos.org/v2/>.